



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 12/08/2021 Ref.: 3019/21

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 87-të, të mbajtur më 07 dhe 27 Korrik 2021, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe i Sportit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën tri vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
 - Edukim Fizik dhe Sport, BA, 240 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik.
 - Trajner Sportiv, MA, 60 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik.
- II. Nuk akreditohet programi i studimit Fakultetit të Edukimit Fizik dhe i Sportit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”
 - Edukim Fizik dhe Sport, MA, 120 ECTS
- III. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit
- IV. Obligohet Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri më datë 15.11.2021 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

I. Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

Nr.	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1	Edukim Fizik dhe Sport, BA, 240 ECTS Ri-akreditim	Florian Miftari Musa Selimi Bylbyl Sokoli Bahri Gjinovci
2	Edukim Fizik dhe Sport, MA, 120 ECTS Ri-akreditim	Hasim Rushiti Malsor Gjonbalaj Afrim Koca
3	Trajner Sportiv, MA, 60 ECTS, Ri-akreditim	Shqipe Bajqinca Besnik Morina

Çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, duhet të raportohet dhe arsyetohet në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar duhet të aprovohet nga KSHC.

AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe të Sportit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Vizita është organizuar më 16.03.2021, me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Chris Richter, Karen Petry dhe Domagoj Vugić.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit, dhe për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:


1. Për programin e studimit Edukim Fizik dhe Sport, BA, 240 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht katër (4) prej tyre, i përmbush pjesërisht dy (2) prej tyre dhe nuk e përmbush një (1).
2. Për programin e studimit Edukim Fizik dhe Sport, MA, 120 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht tri (3) prej tyre, i përmbush pjesërisht tri (3) prej tyre dhe nuk e përmbush një (1).
3. Për programin e studimit Trajner Sportiv, MA, 60 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht katër (4) prej tyre, i përmbush pjesërisht dy (2) prej tyre dhe nuk e përmbush një (1).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 87 të mbajtur më 07. 07. 2021 dhe 27.07.2021 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

